

VENDIM NR. 03 DATE 06.08.2007
I ORTAKVE TE SHOQERISE TREGTARE
"A V E L" SH.P.K .TIRANE

Ne Tirane, sot ne daten 06 , muajit gusht, viti 2007, u zhvillua Mbledhja e Asamblese se Ortakut te Vetem te Shoqerise "A V E L" SH.P.K. Tirane, ne seline e saj , per shqyrtim me rend dite :

1.Zmadhimi i Kapitalit Themeltar te nenshkruar te shoqerise "A V E L" SH.P.K . Tirane ne shumen 58 000 EURO (Pesedhjetetetemije) me kontribute te derdhura ne bank nga ana e ortakut te vetem .

2 .Zmadhimi i Kapitalit Themeltar te nenshkruar te shoqerise "A V E L" SH.P.K . Tirane ne shumen 30 000 000 Lek (Tridhjetemilione) nga fitimet e realizuara nga veprimtaria e shoqerise tregtare, te pashperndara dhe gjendje ne daten 31.12.2006.

3 .Krijimin e rezervave ligjore Nepermjet fitimit gjendje me 31.12.2006 ne shumen 12 582 leke.

Ortaku i Vetem i shoqerise tregtare "A V E L" SH.P.K . Tirane, z. Avni Ponari pasi u njoh me rendin e dites ;

VEREJTI SE

Shoqeria Tregtare "A V E L" SH.P.K .Tirane, eshte regjistruar prane Regjistrimit Tregtar me Vendimin Nr. 28 479 datë 04 . 11 . 2002 të Gjykatës së Rrethit Gjyqesor Tiranë.

Mbasi u analizua veprimtaria tregtare dhe treguesve financiare te shoqerise tregtare "A V E L" SH.P.K .Tirane , Ortaku i vetem , konstaton se , per ecurine me te mire te shoqerise ne te ardhmen, per te patur nje vazhdimesi te qendrueshme dhe siguri te veprimtarise , si dhe per te rritur besushmerine e saj ndaj institucioneve bankare dhe partnereve , te behet zmadhimi i Kapitalit Themeltar te kesaj shoqerie , ne baze te Statutit , Aktit

te Themelimit dhe nenit 62 te ligjit Nr.7638 date 19.11.1992 "Per shoqerite tregtare", me Kontribut ne para te derdhur nga ortakut i vetem si dhe me fitimet e pa shperndara sipas gjendjes se Bilancit te dates 31 Dhjetor 2006 . Per keto arsye , Ortaku i Vetem:

VENDOSI :

- 1 -Zmadhimi i Kapitalit Themeltar te shoqerise "A V E L" SH.P.K .Tirane.
- 2 -Krijimin e rezervave ligjore ne masen 12 592 leke
- 3 -Te caktoje z. Teki Flamuri, antar i dhomes se IEKA , me profesionin Ekspert Kontabel i Autorizuar me Nr. license 106 date 10.01.2001, per :
 - Vleresimin e kontributit te derdhur nga ortakut , ne Euro ne daten 06.08.2007 i cili do te pasqyrohet ne lek konform kerkesave ligjore dhe do sherbeje per shtimin e Kapitalit Themeltar.
 - Verifikimin e ekzitences se fitimeve te pa shperndara te shoqerise , gjendje te dates 31 Dhjetor 2006 me te cilat do te rritet Kapitali Themeltar.

Depozitimi i ketij vendimi pranë Qenders Kombetare te Regjistrimit , TIRANË .

ASAMBLEJA E SHOQËRISË TREGTARE "A V E L" SH.P.K .

ORTAKU I VETEM



(Avdi PONARI)